

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë "COOL TECH" Sh.p.k.

Sot, me datë 11/11/2024,

Z. Bledi Beba, shtetas shqiptar, lindur më 22.04.1981, në Tirane, banues në: Tirane, mbajtës i dokumentit ID I10422146G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Z. Martin Sala, shtetas shqiptar, lindur më 04.04.1989, në Bilisht, banues në: Tirane, mbajtës i dokumentit ID I90404040I, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kane vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**COOL TECH**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**COOL TECH**"

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi KIKA 2, Godina 1C-10, Kati 2, Tiranë, Shqipëri.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Tregti me shumice dhe pakice, import export, te paisjeve te kondicionimit, klimatizimit HVAC (te brendshme dhe te jashtme) rooftop, ahu, chiller, fan coil, vrf, aspirator, recuperator, kondicionerve per shtepi dhe atyre komercial dhe industrial etj. Projektim, insatlim, servis dhe mirembajtje te sistemeve kondicionimit, te ngrohje-ftohje, sistemeve te ajrimit, aksesoreve te tyre, riparim te sistemeve te kondicionimit, konsulence teknike, teknologjike dhe ekologjike, mbikqyrje teknike, trajnime, sherbime, perfaqesi dhe ndermjetsesi tregtare. Instalime sisteme split, multi split,VRF, ajer-uje, sisteme ajer-ajer etj. Panele Diellore, konstruksion sistem ngrohje-ftohje, instalime mekanike. Transport mallrash per vete dhe te trete. Tregetim i artikujve te ndryshem industrial, artikuj dhe pasije te ndryshme elektroshtepiake te medha dhe te vogla, aksesore, sherbim riparime elektroshtepiake, artikujsh dhe sendesh te tjera me qellim rishitje, si dhe çdo veprimtari tjetër qe nuk është ne kundërshtim me rendin juridik ne fuqi.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakeve themelues në vlerën 20,000,000 (njetzet milion) Lek ose 200,000 (dyqind mije euro) dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

Kapitali themeltar zoterohet dhe përbëhet si më poshtë:

- **Z. Bledi Beba**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 10,000,000 (dhjete milion) Leke ose 100.000 (njqind mije) Euro dhe vlerë 10,000,000 (dhjete milion) Leke ose 100.000 (njqind mije) Euro të kapitalit themeltar.
- **Z. Martin Sala**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 10,000,000 (dhjete milion) Leke ose 100.000 (njqind mije) Euro dhe vlerë 10,000,000 (dhjete milion) Leke ose 100.000 (njqind mije) Euro të kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij akti. Vlera e kapitalit do të derdhet në llogarite bankare të shoqërisë deri në fund të muajit dhjetor 2024

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Bledi Beba**, shtetas shqiptar, lindur më 22.04.1981, në Tiranë, banues në: Tiranë, mbajtës i dokumentit ID I10422146G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaket themelues të shoqërisë duke autorizuar Administratorin, **Z. Bledi Beba**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKET THEMELUES

BLEDI BEBA



MARTIN SALA

